

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. DRITAN PRENÇI

06/07/2018

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 05.06.2018 për subjektin e rivlerësimit, z. Dritan Prençi, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 07.06.2018, vendosi:

Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Dritan Prençi, prokuror i përkohshëm në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupa gjyquese e kryesuar nga znj. Genta Tafa (Bungo), znj Suela Zhegu relatore dhe znj. Pamela Qirko anëtare do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.